


**AKTI - THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
CO.GE.FI. SH.P.K.**



Ortaket:

- Ing.Moreno Paolo Torri, lindur ne Cantagallo,Itali me 25 Janar 1950 dhe banues ne Prato,rruga "Ruggero Nuti" n°25.
- Geom.Moreno Bai,lindur ne Castiglione me 09.0.1951 dhe banues ne Prato Rruga Nettuno Nr.8.
- Geom.Massimo Torri,lindur ne Firenze me 15.12.1971 dhe banues ne Calenzano Rruga del Pino Nr.12.
- Llog.Francesco Prinzi,lindur ne Serrata me 04.08.1955 dhe banues ne Prato Rruga Rinicci Nr.4.

kane rene dakord te themelojne nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (sh.p.k.) sipas ligjit Nr. 7638 te 19 Nentorit 1992, ne kushtet qe vijojne:

**NENI 1
Emertimi**

Shoqeria, e cila ne vijim te ketij akti do te quhet shkurtimisht " shoqeri", do te marre emertimin "CO.GE.FI."Sh.p.k.

**NENI 2
Selia**

Qendra e shoqerise do te jete ne adresen Rr. M.JAFYR 754/2/1 Tirane dhe mund te formoje filiale ,ajensi,dyqane dhe magazina ne te gjithe territorin kombetar si edhe jashte tij.

**NENI 3
KOHEZGJATJA**

Kohezgjatja e shoqerise eshte caktuar deri me 31 Dhjetor 2015. Me vendim te asamblese ky akt mund te perseritet per nje ose disa periudha te njejtë kohore.

**NENI 4
Objekti i aktivitetit**

Shoqeria ka per objekt blerjen dhe shitjen e trojeve dhe ndertesave te banesave civile, industriale, tregtare, struktura turistike, impiante sportive, mund te beje sipermarrje per ndertime ne per gjithesi, por te mos realizoje drejtperdrejt punime ndertimi;

Mund te shese, bleje, shkembeje, marre me qira, te marre e drejtoje koncensione per sendet e luajtshme dhe te paluajtshme ne per gjithesi;

Mund te realizoje projekte te çfare dolloj niveli per vete dhe per te tretet, siç mund te tregtoje sendet e paluajtshme dhe tu furnizoje te treteve sherbime teknike e tregtare;

Shoqeria mund te marre persiper kontrata per trajtimin e sendeve te paluajtshme ne per gjithesi si dhe drejtimet turistike e restaurimi, dyqane per shitje me shumice e pakice te te gjithe llojeve ushqimore e jo ushqimore;

Mund te ndermarre aktivitet tregtar,duke perfshire importin dhe eksportin e prodhimeve te peshkut, bujqesore, materiale ndertimi, ushqime te konservuara, lende te para, gjysem te punuara dhe prodhimet e gatshme;

Mund gjithashtu te ndermarre çfaredo veprimit bujqesore, perfshi ate pyjore,kultivimin e bimeve dhe rritjen e kafsheve,si dhe të gjitha aktivitetet qe lidhen me to: transformime, magazinim, therje,dhe mbajtien ne ruajtie.

Shoqeria mund te kryeje te gjitha veprimet e nevojshme sipas gjykimit eksluziv te organit administrativ per te zbatuar objektin soçjal, nder te cilat :

2.

Kryerjen e e operacioneve tregtare e industriale, financiare e bankare, me ipoteken, dhe pasurive te paluajtshme

Mund te ndermarre çfaredo forme financimi me institutet e kredise, bankat, dhe shoqerite duke dhene garancite e duhura reale

Mund te hyje ne shoqerite e tjera dhe te marre pjese ne fitime.

NENI 5 KAPITALI THEMELOR

Kapitali themelor i shoqerise do te jetë 100.000 (njeqind mijë) leke, i cili eshte derdhur i teri prane Banken Italo-Shqiptare, Tirane.

Kapitali themelor eshte perbere nga 100 (njeqind) pjese te barabarta (kuota), me nje vlore nominale 1000 (njemije) leke secila dhe eshte nenshkruehet si me poshte vijon:

- Ing. Moreno Torri	40% (dyzet) kuota.
- Geom. Moreno Bai	40% (dyzet) kuota.
- Geom. Massimo Torri	10% (dhjete) kuota.
- Llog. Francesco Prinzi	10% (dhjete) kuota.

NENI 6 ADMINISTRIMI

Per ushtrimin e pare shoqeria do te administrohet nga nje administrator i vetem qe emerohet qe tashti Z.Luan Bega, lindur ne Sarande me 14\07\1949 dhe banues ne Tirane, Rruga B.Biba n°75\1\11 qe deklaron se e pranon kete detyre, e cila do te zgjase deri me 31 Dhjetor 1996 dhe qe nenkupton se mund te rinovohet heshtazi qdo vit.

Paga e administratorit per veprimtarine e pare eshte caktuar ne Lireta 200.000(dyqintmije) ne muaj. Administratori duhet te respekoje çka eshte parashikuar ne statut dhe ligjet ne fuqi.

NENI 7 VEPRIMATARIA

E gjithe veprimtaria perfshi edhe ate te ketij vitit mbylljet me 31 Dhjetor.

NENI 8

Per gjithçka qe nuk eshte parashikuar ne kete akt themelimi, do ti referohet dispozitave qe permban Statutin i shoqerise, Ligjeve ne fuqi si dhe te Kodit Civil te RSH.

U lexua, u aprovua dhe u nenshkrueua,

Tirane, me _____.1998

Nenshkruesit:

Per; Ing. Moreno TORRI, Geom. Moreno BAI, Geom. Massimo TORRI, Llog. Francesco Prinzi

Me Prokure te posaçme Nr.30.636 date 20 mars 1998

STEFANO MATTEI

Ky akt themelimi permban Nr.8 (-tete) nene dhe ze 2 (dy) faqe te daktilografuara, ne 4 kopje te barabarta.